

**asnjë
njeri nuk
është
illegal**

**Pa letra-ti
ke të drejta!**

Ky botim ekziston në gjuhën shqipe, gjermane, franceze, spanjolle, portugeze, serbokroate, turke dhe angleze.

2007 – Botim i Sindikatës Unia dhe këshillimoreve për «Sans Papier» në të Zvicrës gjermanofolëse.

A jeton dhe punon në Zvicër pa leje qëndrimi?

Atëherë nuk je vetëm! Në Zvicër jetojnë më së paku 100 000 njerëz si ti. Atyre u thonë «Sans Papiers» (Pa Letra) ose «illegalë». Shumica prej tyre janë në të vërtetë «Punëtor/e me leje-qëndrim të parregulluar». Ata pastrojnë, kujdesen për fëmijë, punojnë në ndërtimtari, nëpër restorante apo te bujqit.

Edhe nëse ti jeton në Zvicër pa leje qëndrimi, ke të drejta themelore. Të drejtat e njeriut nuk janë të ndërlidhura me statusin e qëndrimit. Ato vlejnë për të gjithë.

Kjo fletushkë përmban informata të dobishme mbi jetën e përditshme dhe të jep sqarime mbi të drejtat tua elementare. Ndhimë mund të japin edhe këshillimoret, grupet e solidaritetit, sindikatat ose avokatët (shiko adresat në brendi).

1. Legalizimi i qëndrimit

Njerëzit jashtë BE-së nuk kanë gati kurrfarë mundësish për të arritur deri te leja e qëndrimit për Zvicër. Për «Sans Papiers» (njerëzit pa letra) ekzistojnë faktikisht vetëm mundësit e lejes së qëndrimit për raste të rënda apo martesë.

Leje-qëndrimi për raste të rënda

Ligji parasheh që migrantët, të cilët qëndrojnë në Zvicër pa bazë ligjore, duhet menjëherë të lëshojnë në Zvicrën. Përjashtim bëhet vetëm nëse është fjala për raste të rënda.

Në raste të rënda mund të parashtrohet kërkesa individuale për rregullimin e qëndrimit. Autoritetet e trajtojnë çdo kërkesë në mënyrë intensive. Gjatë trajtimit, me rëndësi janë kriteret si: kohëzgjatja e qëndrimit, puna, integrimi, shkollimi i fëmijëve, shëndeti dhe të tjera.

Autoritetet nisen nga ajo, se gjatë një qëndrimi prej më pak se katër vite nuk bëhet fjalë për rast të rëndë. Vetëm gjatë një qëndrimi më të gjatë bëhet trajtimi serioz i kërkesës. Përveç tjerash,

ardhmëria e këtyre rregullimeve individuale të rasteve të rënda sot (2007) është më se e pasigurt.

Ish azilkërkuesit, të cilët janë zhdukur (në ilegalitet) e kanë edhe më vështirë: Për ta parimisht nuk ekziston mundësia e një procedure të re e as për një kërkesë për raste të rënda.

Kujdes! Rastet e rënda autoritetet gjithmonë i vendosin në mënyrë subjektive apo sipas gjykimit dhe mendimit të tyre.

Martesa

Secili njeri ka të drejtë të martohet. Në jetën e përditshme kjo për njerëzit pa letra nuk është e lehtë, pasi që u mungon leja e qëndrimit. Në disa Kantone mund të martohesh në vend. Në tjera Kantone kërkohet të kthehesh në vendlindje dhe të hyjsh legalisht me një vizë. Nëse dyshohet se martesa është martesë e rrejshme (gjoja se martesë), atëherë ofiqari mund të refuzoj lidhjen e martesës.

Kujdes! Nëse në pesë vitet e para prishet martesa, prej vitit 2008 pas tri vitesh, kërcënohet humbja e lejes së qëndrimit.


Kërkesa: Rregullimi kolektiv

Njerëzit pa letra, së bashku me grupet përkrahëse, luftojnë me vite për një rregullim kolektiv në Zvicër. Disa suksese janë arritur: mbi një mijë leje të qëndrimit dhe e drejta për sigurim shëndetësorë.

Në regjionet në të cilët «Sans Papiers» janë të organizuar mirë mund të hapen rrugë të reja. Si shembull: një fushatë e madhe në Gjenevë ka sjellë deri te ajo, që ky kanton në janar 2005 të kërkojë nga Berna 5000 leje qëndrimi për të punësuarit nëpër amvisni.

Për këtë arsye, angazhohu në njërin nga kolektivët e shumtë për njerëz pa letra.





2. Shëndeti

«Sans Papiers» jetojnë në kushte tejet të rënda. Puna shpesh është e rëndë dhe e dëmshme për shëndetin. Kësaj i shtohet stresi i jetesës në ilegalitet, larg vendlindjes dhe familjes. Të gjitha këto mund të kenë pasoja për shëndetin tënd dhe mirëvajtjen tënde shpirtërore. Dhimbjet e shpinës, gjendja e keqe shpirtërore dhe depresionet janë shenja alarmuese, të cilat duhet t'i marrësh me seriozitet.

Mos qo jetë vetëm për të tjerët dhe për të ardhmen. Merr kohë për gjërat, të cilat i bën me dëshirë. Bashkohu me të tjerët, për t'i shpëtuar izolimit.

E drejta për shërbime shëndetësore

Shëndeti është e drejta e njeriut, edhe për një-rëz pa letra ! Nëse je i sëmurë ose i lënduar, atëherë duhet të të mjekojnë, edhe nëse nuk ke sigurim shëndetësor. Në spitale ekzistojnë shërbimet sociale. Ato mundë të ndihmojnë në rast të problemeve.

Mjekët dhe spitalet janë të detyruar/a të ruajnë sekretin. Ata/ato nuk guxojnë t'ia japin policisë të dhënat tua.

E drejta për sigurim shëndetësor

Ti ke të drejtë të bësh një kontratë të sigurimit shëndetësor dhe për raste fatkeqësie. Shpenzimet e mjekimeve, qëndrimeve në spital, shtatzënisë dhe lindjes mbulohen nga arkat e sigurimit shëndetësor. Mjekimi i dhëmbëve nuk është i siguruar.

Sigurimi shëndetësor kushton. Muaj për muaj ti paguan një kontribut të quajtur «Premi». Në disa Kantone ekziston mundësia e kërkesës për lirim të premisë, nëse të ardhurat janë të ulëta (informohu në këshillimore).

Edhe arkat e sigurimit i nënshtrohëm ruajtjes së sekretit. Megjithatë ne të rekomandojmë, që gjatë bërjes së kontratës së sigurimit të japësh adresën e një personi «legal» të besueshëm.



Mbrojtja prej shtatzënisë /HIV-SIDA

Mjekët, spitalet dhe këshillimoret e veçanta informojnë mbi mjete parandalimi të shtatzënisë dhe abortimit (adresa prapa).

Prezervativët (gomat) mbrojnë gjatë marrëdhënies seksuale nga HIV/Sida dhe mund të blihen pa recetë në barnatore apo shtëpi të mallrave.

3. Puna

Nëse ti me ndonjë person merresh vesh, që të punosh për të dhe ai ty të premtun një rrogë, atëherë kjo vlen si kontratë pune, edhe nëse marrëveshja është bërë gojarisht.

Kontrata të garanton kushte minimale të punës:

- Të drejtë për rrogë të zakonshme të profesionit dhe vendit.
- Të drejtë për pushime të paguara (në të shumtën e rasteve 4 javë në vit).
- Afate të arsyeshme të prishjes së kontratës. Punëdhënësi duhet të informoj herët, se nuk do të të punësoj më tutje.
- Vazhdimësia e pagesës së rrogës gjatë një kohe të caktuar në rast sëmurje apo fatkeqësie.
- Sigurimi i pleqërisë dhe i të mbeturve AHV dhe sigurimi në rast të invaliditetit IV (shiko kapitullin sigurimet sociale)

- Te të miturit: Ndalim pune për moshën më të ulët se 15 vjeç. Nën 18 vjeç ndalim pune natën dhe të dielën. Më së shumti 9 orë punë në ditë. Nëse punon si punëtore e amvisërisë (shtëpiake) dhe banon te punëdhënësi yt, atëherë ata duhet të të japin hapësirë banimi, e cila e mbron sferën tënde private. Shkollimi i obligueshëm: Ti ke të drejtë shkollimi gjatë nëntë viteve, edhe pa leje qëndrimi.

Njerëzit pa letra shpesh marrin rroga të ulëta apo nuk marrin fare. Nëse biseda e drejtpërdrejtë me punëdhënësin nuk sjellë rezultate, atëherë në disa kantone ke të drejtë padie pranë gjyqit të punës. Informohu!

Padinë para gjyqit mund ta bëj një person i autorizuar nga ti. Kështu që ti mundesh, edhe në rast kthimi në vendlindje, deri pesë vite më vonë të kërkohesh të drejtat tua nëpërmjet gjyqit.

Këshillë: Nëse prezantohesh për herë të parë te punëdhënësi, atëherë parashtro pyetje mbi punën: sa do të fitosh? Sa orë duhet të punosh? Cilat punë duhet t'i bësh e cilat jo? Sipas mundësisë, merr vesh për orar të caktuar.



Kjo është sidomos me rëndësi nëse banon te punëdhënësi (të punësuarit në amvisni). Gjithashtu merru vesh, se cilat ditë i ke të lira. Pyet, se a mundë t'i kesh me shkrim këto marrëveshje (kontratë pune).

Këshillë: Shkruaj çdo ditë sa dhe çka ke punuar. Ruaji fletët që përmbajnë udhëzime pune. Nëse e ke dokumentuar punën e bërë, atëherë do ta kesh më lehtë t'i nxjerrësh të drejtat e tua, nëse ke probleme me punëdhënësin.

Këshillë: Ti si «Pa Letra» mund të anëtarësohesh pa vështirësi në ndonjë Sindikatë. Kjo p.sh. mund të të përfaqësoj në proceset gjyqësore.

Sigurimet sociale

Sigurimet sociale janë të obligueshme për të gjithë njerëzit, të cilët jetojnë në Zvicër. Kryesoret janë: Sigurimi i pleqërisë dhe për të mbeturit (AHV), Sigurimi në rast invaliditeti (IV/AI), Sigurimi i papunësisë (ALV), Sigurimi i fatkeqësisë (UVG) dhe Përkujdesja profesionale (LPP ose Arka e Pensionit).

Secili punëdhënës duhet t'i lajmëroj punëtorët te sigurimi social. Këto nuk denoncojnë (lajmërojnë) njerëzit pa letra te policia për të huajë.

Nëse je i lajmëruar pranë sigurimit social, do të marrësh një kartë ngjyrë hiri të sigurimit (legjitimacion i sigurimit, kartë e AHV-së). Punëdhënësi ty ende të punëson ilegalisht, por ti je i siguruar kundër fatkeqësisë dhe invaliditetit dhe në pleqëri e merr një pension (edhe në vendlindje).

Vini re! Ekzistojnë punëdhënës, të cilët kontributet e sigurimeve sociale i zbresin nga roga, mirëpo nuk i paguajnë te sigurimet ! Nëse nuk e ke kartën e AHV-së, d.m.th. punëdhënësi yt nuk të ka siguruar.

Këshillë: Bisedo me punëdhënësin tënd mbi mundësitë e lajmërimit te sigurimet sociale. Informohu paraprakisht mbi praktikën e zakonshme në kantonin e banimit.

4. Kopshti për fëmijë dhe shkolla

Shkollat publike janë të detyruara të bëjnë shkollimin e të gjithë fëmijëve të cilët jetojnë në Zvicër, pa marrë parasysh statusin e qëndrimit – d.m.th. edhe fëmijët e njerëzve pa letra. Kjo vlen deri në klasën e 9. Edhe vajtja në kopsht të fëmijëve është e mundshme.

Në disa kantone ekziston mundësia e vazhdimit të shkollimit p.sh. në gjimnaz. Shkollimi profesional për të rinjtë «Pa letra» nuk është i mundshëm.

Shkolla dhe mësuesit nuk guxojnë t'i japin policisë të dhënat mbi fëmijët.

Këshillë: Mësueset/it janë persona besimi dhe gati gjithmonë kanë mirëkuptim për situatën e vështirë të fëmijëve të njerëzve pa letra. Merr pjesë në mbrëmje të prindërve dhe manifestime tjera të shkollës. Nëse ke frikë, shko në përcjellje.





5. Kurse të gjuhës

Ne të sugjerojmë të mësosh gjuhën lokale. Njohja e gjuhës është një përparësi e madhe në jetën e përditshme. Kështu mund të marrësh pjesë në jetën e përditshme në vend dhe mund të angazhohesh në mënyrë efektive për të drejtat tua. Pyet në këshillimore për kurse të përshtatshme të gjuhës.



6. Banimi

Pa leje qëndrimi është vështirë për të gjetur banesë. Njerëzit «Pa Letra» shpesh paguajnë qira të madha dhe kanë banesa të vogla.

Kjo funksionon më së lehti nëse banesën e merr me qira në emër të një personi, i cili ka leje qëndrimi. Mirëpo, ky person shkelë ligjin dhe mund të dënohet. Pronari i banesës nuk guxon të kërkoj qira më të madhe se qiratë e zakonshme të rrethit. Edhe qiraja nuk mund të jetë shumë më e lartë se ajo e personit që ka banuar më parë aty.

Pronari mund të kërkoj depozitim të qirasë deri në shumën maksimale prej 3 qirave mujore. Nëse ti qiranë e paguan me kohë dhe nuk bën dëme në banesë, atëherë kjo depo duhet të të kthehet, sapo të largohesh nga banesa. Kërko një fature për depon e paguar.

Këshillë: Pyete pronarin për fletëpagesa. Paguaje banesën në postë me emrin tënd të vërtetë. Fletëpagesat janë dëshmi më e mire për qiratë e paguara, edhe nëse më vonë pronari parashton kërkesa.

Këshillë: Nëse pronari kërkon qira tepër të lartë ose nuk e kthen depon, atëherë mundohu nëpërmjet njërës nga këshillimoret të bisedosh me të. Nëse kjo nuk ka sukses, atëherë në disa vende ekziston mundësia për t'u ankuar te një «vend pajtimi».

7. Policia

Nga këndvështrimi i autoriteteve ti shkelë ligjin vetëm me faktin se qëndron këtu pa letra. Puna pa letra është edhe një delikt më shumë.

Nëse autoritetet marrin veshë se qëndron në Zvicër pa letra, në shumicën e rasteve do të largohesh nga Zvicra dhe të ndalohet hyrja në vend për 2–3 vite. Përveç saj mund të dënohesh me gjobë dhe burg.

Policia për të huaj mund të urdhëroj arrest për largim. Ti do të mbahesh në arrest deri sa autoritetet i rregullojnë formalitetet mbi largimin tënd. Ligjshmëria e këtij arresti duhet të shqyrtohet nga një gjykatës brenda 96 orësh. Arresti për largim, plus arresti i mundshëm për realizimin e dëbimit, mund të zgjasin maksimalisht 24 muaj.

Kontrollet policore dhe të drejtat tua

- Policia ka të drejtë të të ndaloj dhe të të kontrolloj dhe vërtetoj të dhënat personale.
- Pa leje qëndrimi është më se e mundshme që do të të marrin në stacion policorë. Aty kërko të të mundësohet kontaktimi me një avokat ose këshillimore.
- Pastaj fillon marra në pyetje. Personi i cili të pyet duhet të të trajtoj në mënyrë korrekte; nuk guxon të ketë kërcënime, nuk guxon të ketë dhunë fizike.
- Për marrjen në pyetje kërko një përkthyes/e. Mos u përgjigj dhe mos nënshkruaj kurrë asgjë, nëse nuk ke kuptuar si duhet dhe sa duhet.
- Ti ke të drejtë të refuzosh deklarinimin. Nuk je i detyruar të japësh informata mbi adresën e banimit, punëdhënësit ose miqtë. Mund të përgjigjesh: «Nuk kam çfarë të them në lidhje me këtë». Më së miri është të mos thuash asgjë, se sa të gënjesht. Gënjeshttrat kuptohen shpejtë dhe ti bëhesh i pabesueshëm. Të dhënat tua

personale si emri, mbiemri, data e lindjes dhe prejardhja, duhet t'i japësh.

- Gjatë kontrollit të thjeshtë, policia nuk ka të drejtë që pa arsye të bëjë kontroll të trupit, d.m.th. të të prekë nëpër trup ose në pjesë intime. Nëse kontrollohesh, atëherë kërko që këtë ta bëj një person i gjinisë tënde.
- Policia ka të drejtë bastisje të banesës vetëm me urdhëresën për bastisje të shtëpisë.
- Kërko fatura (vërtetime) për gjërat, të cilat policia i ka konfiskuar. Kërko, që gjërat, si shënimet personale, kalendarin ose të ngjashme të vulosen dhe mbyllen. Nëpunësit e policisë nuk kanë të drejtë t'i lexojnë ose t'i shumëfishojnë ato. Vetëm gjykatësi hetues ka të drejtë të heq vulën.
- Shpërdorimet patjetër lajmëroi pranë organizatës për të drejtat e njeriut «Augenauf».

Adresa të dobishme

Bazel

Anlaufstelle für Sans-Papiers Rebgasse 1 (1.Stock), 4058 Basel,
T +41 61 681 56 10, www.sans-papiers-basel.ch

Union der Arbeiter/-innen ohne geregelten Aufenthalt

c/o Interprofessionelle Gewerkschaft der Arbeiter/-innen (IGA),
Oetlingerstrasse 74, 4057 Basel, T +41 61 681 92 91, www.viavia.ch

Gewerkschaft Unia Rebgasse 1, 4058 Basel,

T +41 61 686 73 00, www.unia.ch

Universitätsfrauenklinik Sozialdienst (Karin Hänggi), Spitalstrasse 21,
4031 Basel, T +41 61 265 90 64

Augenauf Postfach, 4005 Basel, T +41 61 681 55 22, ww.augenauf.ch

Cyril

Sans-Papiers-Anlaufstelle Zürich (SPAZ) Stauffacherstrasse 60,
Postfach 1536, 8026 Zürich, T +41 43 243 95 78, www.s-paz.ch

Colectivo Sin Papeles Zurich Postfach, 8023 Zürich,
colectivosinpapeleszurich@yahoo.es

Gewerkschaft Unia Stauffacherstrasse 60, 8004 Zürich,

T +41 44 296 18 18, www.unia.ch

Meditrina (Gesundheitszentrum)

Anwandstrasse 7, 8004 Zürich, T +41 44 291 92 33,
www.msf.ch/meditrina

**FIZ Fraueninformationszentrum für Frauen aus Afrika, Asien,
S-Amerika und O-Europa** Badenerstrasse 134, 8004 Zürich,

T +41 44 240 44 22, www.fiz-info.ch

Augenauf Postfach, 8026 Zürich, T +41 44 241 11 77,
www.augenauf.ch

Bern

Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers Schwarzorstrasse 124,
3007 Bern, T +41 31 385 18 27, www.sans-papiers-contact.ch

Sans-Papiers-Kollektiv Bern Quartiergasse 17, 3013 Bern,
T +41 78 801 26 34, www.sans-papiers-bern.ch

Gewerkschaft Unia Monbijoustr. 61, 3001 Bern,
T +41 31 385 22 22, www.unia.ch

Medizinische Beratungsstelle für illegalisierte Frauen (Mebif)
Schwarzorstrasse 124, 3007 Bern, T +41 79 666 95 72, www.mebif.ch

Zentrum für Familienplanung Effingerstrasse 102, Geschoss D,
3010 Bern, T +41 31 632 12 60, familienplanung.fkl@insel.ch

Augenauf Postfach 363, 3000 Bern 11, T +41 31 332 02 35,
www.augenauf.ch

VD

La Fraternité Place Arlaud 2, 1003 Lausanne,
T +41 21 213 03 53, www.csp.ch

Collective vaudois de soutien aux sans-papiers Case postale
5758, 1002 Lausanne, T +41 76 448 62 67, www.sans-papiers-vd.ch

Collectif de soutien et de défense des sans-papiers de la Côte
14, rue Mauverney, 1296 Gland, T +41 22 362 69 88,
www.interculturel.ch/sanspapiers.htm

Coordination Asile Vaud www.stoprenvoi.ch

Syndicat Unia Place de la Riponne 4, 1002 Lausanne,
T +41 21 310 66 00, www.unia.ch

GE

Collectif de soutien aux sans-papiers

25, rte des Acacias, 1227 Acacias, Genève, T +41 22 301 63 33,
www.sans-papiers.ch/geneve

Collectif des travailleuses et travailleurs sans statut légal (CTSSL)

c/o Centre de contact suisses - immigrés (CCSI), 25, rte des Acacias,
1227 Acacias, Genève, T +41 22 301 63 33, +41 78 756 57 87

Unité mobile de soins communautaires HUG

4, Rue Hugo-de-Senger, 1205 Genève,
T +41 22 382 53 11, +41 79 447 36 57

Syndicat Unia 5, chemin Surinam, 1211 Genève,

T +41 22 949 12 00, www.unia.ch

FR

Centre de contact suisse-immigrés (CCSI)

Bd. de Pérolles 91, Case postale 218, 1705 Fribourg,
T +41 26 424 21 25, www.ccsi-sos-racisme.ch

Frisanté, Permanence médicale 12, rue François-Guillimann,
1700 Fribourg, T +41 26 341 03 30

Syndicat Unia Rue des Alpes 11, 1701 Fribourg,

T +41 26 347 31 31, www.unia.ch

VS

Centre de contact suisse-immigrés (CCSI) Avenue de Mayenets 27,
1950 Sion, T +41 27 323 12 16, csivs@bluewin.ch

TI

Movimento dei Senza Voce Via Paradiso 7B, 6500 Bellinzona,
T +41 91 825 05 63, +41 79 794 83 88, www.senzavoce.ch

Zvicër në përgjithësi

Avokatët Demokratische Jurist/-innen Schweiz, www.djs-jds.ch

Sans-Papiers www.sans-papiers.ch

Sindikata Unia Sekretariati qendrorë, Weltpoststrasse 20,
3000 Bern 15, T +41 31 350 21 11, www.unia.ch

Ndërkombëtare

Politika dhe fushatat Platforma për bashkëpunim ndërkombëtarë
në çështjen e migrantëve pa dokumente (PICUM), www.picum.org

Adresat në tërë Evropën Rrjeti Evropian kundër nacionalizmit,
racizmit, fashizmit dhe në përkrahje të migrantëve dhe refugjatëve,
www.united.non-profit.nl



UNIA

**Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.**



Kjo Broshurë është botuar nga Sindikata Unia dhe Këshillimorja «Sans-Papier» në Bazel, dhe përkrahur nga Juristët/et demokratik/e të Zvicrës, Fondacioni Gertrud Kurz dhe HEKS.